



**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR  
ARSIMIN PARASHKOLLOR  
*BASHKIA KORÇË***

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
1.1 Qëllimi .....	4
1.3 Shtrirja .....	5
1.4 Vizioni .....	5
1.5 Misioni.....	5
1.6 Objektivat.....	6
1.7 Përgjegjësitë .....	6
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit .....	7
2.1 Qëllimi .....	7
2.2 Objektiva të përgjithshëm .....	7
2.3 Regjistrimi i fëmijëve .....	7
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht.....	7
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor .....	36
2.4.1 Këshilli i Prindërve .....	36
2.4.2 Bordi i Kopshtit .....	46
2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit .....	57
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit .....	67
3.1 Qëllimi .....	67
3.2 Objektiva të përgjithshëm .....	67
3.3 Përfshirja sociale .....	67
3.3.1 Koncepti i përfshirjes sociale .....	67
3.3.2 Identifikimi i nevojave për përfshirje sociale.....	69
3.3.3 Ndihma e përditshme .....	80
3.4 Mbrojtja e fëmijëve .....	85
3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.1 Adresimi i prindërve .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
3.5.3 Ndihma e përditshme .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit **Error! Bookmark not defined.**

4.1 Qëllimi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.2 Objektiva të përgjithshëm .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.3 Burimet Njerëzore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.3.1 Rekrutimi i stafit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.3.2 Trajnimi i stafit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.4 Menaxhimi i godinave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.5 Materialet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.5.2 Prokurimi i materialeve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.6 Ushqimi.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4.6.1 Transporti dhe ruajtja e ushqimit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
5. Buxheti .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## 1. Hyrje

Në Shqipëri në vazhden e ndryshimeve politike, në 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat u përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për arsimin, Bashkisë i kalon në njuridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër Bashkia Korçë harton planin strategjik, në kuadër të përmirësimit të shërbimit.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qendrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit parashkollor. Arsimi parashkollor, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Korçë. Bashkia Korçë ka nevojë të sigurojë në organigramën e saj një sektor përgjegjës për arsimin parashkollor, për ofrimin e shërbimit cilësor në arsimin parashkollor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qendrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit parashkollor, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Korçë.

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Korçë duke synuar të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor:

- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshteve, me qëllim përsimrësimin e shërbimit në kopshtet e Bashkise, si ne godina me vete dhe ato brenda shkollave te cilat kanë nevojë për restaurim;
- Ngritja e një Strukture ose Sektori Përgjegjës për Arsimin Parashkollor. Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;

- Përmirësimi i shërbimit në kopshte nëpërmjet bashkëpunimit me Qendrën Qyteti i Fëmijëve, ku mund të ofrohen edhe aktivitete edukuese, kreative dhe argetuese për fëmijet e arsimit parashkollor;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit parashkollor, sipas së cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga autoritetet dhe administrata vendore si dhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të rritur standardin e shërbimit;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjiktë Plani, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij. Ndërkohë shpjegohet në mënyrë të detajuar procesi dhe fazat nëpër të cilat ka kaluar ndërtimi i këtij plani përmirësimi.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm.

Ndërkohë në pjesën e tretë janë zhvilluar projekte konkrete se si bashkia të realizojë ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

### **1.3 Shtrirja**

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Korçës. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Korçë. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Personi Përgjegjës për Arsimin Parashkollor, pranë Bashkisë Korçë.

### **1.4 Vizioni**

Arsim gjithëpërfshirës për çdo fëmijë të territorit të Bashkisë së Korçës.

### **1.5 Misioni**

Fuqizimi dhe prioritizimi i arsimit parashkollor, si çelësi kryesor i zhvillimit të suksesshëm të brezave të ardhshëm.

## 1.6 Objektivat

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Korçës. Ai do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Korçë. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Personi Përgjegjës për Arsimin Parashkollor pranë Bashkisë Korçë.

Objektivat e planit janë si më poshtë:

- Ngritja dhe fuqizimi i sektorit të Arsimit Parashkollor pranë Bashkisë Korçë;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet zbatimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Hartimi i një kontrate bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Qytetit të fëmijëve për fëmijet e arsimit parashkollor;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi, Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit);
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me aftësi ndryshe dhe në nevojë për përfshirje sociale.

## 1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinatoriplanit:
  - Personi përgjegjës për arsimin parashkollor, I cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
  - Personi përgjegjës për Njësinë e Shërbimit Social.
2. Aktorët zbatues të planit:
  - Drejtues kopshti;
  - Mësues I kopshtit;
  - Komuniteti;
  - PMF;
  - Psikolog;
  - GTN;
  - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
  - Kryetari I Bashkisë;
  - Këshilli I Bashkisë.
  - SDC;
  - Smart Processes;

## 2. Procesi i Menaxhimit- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë, etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

### 2.2 Objektiva të përgjithshëm

Planifikim, zbatim, monitorim dhe kontroll efikas i shërbimit të kopshtit, në kuadër të përmirësimit të cilësisë në Arsimin Parashkollor.

### 2.3 Regjistrimi I fëmijëve

#### 2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

##### *Informacion i përgjithshëm*

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Korçë është **1706** prej të cilëve 780 janë vajza. Numri i vajzave të regjistruara në kopshtet publike në total rezulton të jetë më i vogël se numri i djemve të regjistruar. Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës, përjashtim bën Njësia Administrative Bulgarec, Vithkuq dhe Voskop, ku numri i vajzave të regjistruara është më i lartë se numri i djemve.

Bashkia Korçë ka kapacitetet akomodues për **2245** fëmijë në kopshtet publike, për të tre grupet e fëmijëve (grupi i parë, grupi i dytë dhe grupi i tretë). Siç vihet re nga të dhënat e mësipërme, si në qytetin e Korçës ashtu edhe në njësitë e tjera administrative, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është më i ulët në raport me kapacitetet akomoduese që këto kopshte posedojnë.

Megjithatë, në kopshtet e qytetit të Korçës numri i fëmijëve të regjistruar është më afër kapacitetit në krahasim me kopshtet pranë njësive administrative.

Ndërkohë vihet re që në Bashkinë e Korçës kemi 28 kopshte që funksionojnë brenda shkollave, ndërkohë që kemi në total 43 kopshte publike. Në territorin e Bashkisë së Korçës operojnë 4 kopshte private në total. Të gjitha kopshtet private ndodhen në qytetin e Korçës, dhe vetëm 1-ri prej tyre ndodhet brenda godinës së shkollës. Megjithëse sektori privat përbën vetëm 9% të sektorit të kopshteve, ai ka rreth 13% të fëmijëve të regjistruar në kopshte.

Shpërdarja gjeografike e kopshteve, është jo lineare. Sipas të dhënave të raportit, qyteti i Korçës ka numrin më të madh të kopshteve publike (13 kopshte), ndërsa Njësia Administrative Voskopjë (2 kopshte) dhe Vithkuq (3 kopshte) kanë numrin më të vogël të kopshteve.

Siç mund të vihet re, numri më i lartë i regjistrimeve është në kopshtet e Qytetit të Korçës (1093 fëmijë), ndërsa numri më i ulët i regjistrimeve është në kopshtet e Njesisë Administrative Voskopoje (29 fëmijë).

***Kopshtet pranë Njësive Administrative janë drejt mbylljes, për shkak të numrit të ulët të regjistrimeve.***

Ndërkohë, për sa i përket ndarjes në grupe, vihet re ekzistenca e grupeve të përziera dhe numri më i lartë i grupeve të përziera ndodhen në kopshtet publike të njësisë administrative Bulgarec, përkatësisht 12 grupe nga 17 grupe në total. Ndërkohë shihet që numri i grupeve të para dhe të treta është më i lartë se i grupeve të dyta. Numri i fëmijëve të regjistruar në grupin e tretë është 457, numri i fëmijëve të regjistruar në grupin e dytë është 367 fëmijë dhe numri i fëmijëve të regjistruar në grupin e parë është 446.

#### *Objektiva kryesore:*

Përmirësimi i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht bazuar në avantazhet e TIK dhe praktikave të mira.

#### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Regjistrimi i fëmijëve në kopshte sipas kapaciteteve akomodues
2	Respektimi i standardeve për sa i përket numrit të fëmijëve në grupe
3	Parashikimi dhe projeksionimi i numrit të fëmijëve që do regjistrohen në kopshte në planin 3-vjecar
4	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale





Nr	Pershkrimi
5	Rritja e cilësisë në administrimin dhe monitorimin e kopshteve nëpërmjet ndërtimit të instrumentave teknologjikë.
6	Rritja e menaxhimit dhe monitorimit të kopshteve pranë NJA-ve që ndodhen brenda godinave të shkollave (33), të cilat aktualisht menaxhohen nga drejtorët e shkollave

*Indikatorët e performancës*

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Fshat	Vlere	Shumatore				
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Periferi	Vlere	Shumatore				
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Qender	Vlere	Shumatore				
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Fshat	Vlere	Mesatare				
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Periferi	Vlere	Mesatare				
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Qender	Vlere	Mesatare				

002	Norma e regjistrimit në kopsht	Fshat	%	Tjeter				
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Periferi	%	Tjeter				
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Qender	%	Tjeter				
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Fshat	Vlere	Shumatore				
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Periferi	Vlere	Shumatore				
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Qender	Vlere	Shumatore				
010	Numri i punonjësve në Njësinë që menaxhon arsimin parashkollor brenda Bashkisë	Bashki	Vlere	Shumatore				
009	Instrumenta teknologjike për dixhitalizimin dhe menaxhimin e të dhënave	Bashki	Vlere	Shumatore				

*Lista e Aksioneve*

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periodhe
008	Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve për akomodimin e aktiviteteve të fëmijëve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0	0	0	0
007	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0	0	0	0
006	Regjistrimi në kopsht sipas banimit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0	0	0	0
005	Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0			0
004	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce			0		0
003	Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0	0	0	0



002	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce		0			0
001	Ngritja e strukturës përgjegjëse për arsimin parashkollor	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkine Korce	0	765.6	765.6	765.6	2296.8

## Lista e projekteve

Nr. 001	<b>Projekti:</b> Ngritja e strukturës përgjegjëse për arsimin parashkollor	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Në organogramën e Bashkisë së Korçës nuk ka pasur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e arsimit parashkollor. Zyra e Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës, dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për menaxhimin e disa procedurave të funksionimit të kopshteve në territorin e bashkisë.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Gjatë vitit 2020, falë bashkëpunimit të Bashkisë Korçë dhe ekipit të punës së projektit Bashki të Forta, është punësuar një person përgjegjës, me detyrë Keshilltare per Arsimin Parashkollor prane Kabinetit te Kryetarit te Bahkise.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
<p>Synimi i këtij projekti është ngritja dhe konsolidimi i strukturës brenda bashkisë e cila do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e arsimit parashkollor. Bashkia Korçë ka punësuar një person përgjegjës për arsimin parashkollor.</p>		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>		
<b>A: Ligjore</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>Miratimi në KB i buxhetit për personin përgjegjës të arsimit parashkollor.</li> </ol>		

**B: Menaxheriale**

1. Trajnimi i punonjësit të ri për përgjegjësitë dhe njohja me kontekstin e bashkisë dhe situatës aktuale të arsimit parashkollor.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Miratimi i buxhetit në KB. Paga e punonjësit = 63.8 mijëlekë (paga bruto)
2. Trajnimi i punonjësit të ri përpërgjegjësitë dhe njohja me kontekstin e bashkisë dhe situatës aktuale të arsimit parashkollor.

Pagat janë bazuar në Urdhrin e Bashkisë Korçë, "Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2018".

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të kopshteve;
2. Ofrimi i shërbimit psiko-social për fëmijët në moshë kopshti nga bashkia;
3. Rritja e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Kryetari i Bashkisë
- Keshilltarja e Kryetarit të Bashkisë për Arsimin Parashkollor
- N.Sh.M.A.C

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

Nr	Emertimi	Përgjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Miratimi i strukturës dhe buxhetit në KB	Kabineti I Kryetarit të bashkisë		765.6	765.6	765.6	2296.8
2	Trajnimi i punonjësit të ri për përgjegjësitë dhe njohja me	Kabineti I Kryetarit të bashkisë		0			0

	kontekstin e bashkisë dhe situatës aktuale të arsimit parashkollor.						
				765.6	765.6	765.6	2296.8
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Kabineti I Kryetarit te bashkise dhe NSHMAC			

Nr. 002	<b>Projekti:</b> Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	<b>Programi Buxhetor: 09120 -</b> Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni: 09</b>
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçë, nuk disponon një listë të fëmijëve në moshë kopshti. Si pasojë, nuk mund të bëjë parashikime dhe të planifikojë saktësisht mbulimin me shërbim të kopshtit.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja përndërhyrje</b>		
<p>Duke mos pasur një numër të fëmijëve në moshë kopshti, nuk është e qartë norma e regjistrimit të fëmijëve në kopsht. Regjistrimi dhe frekuentimi në kopsht nuk janë të detyrueshëm, megjithatë arsimit parashkollor është shumë i rëndësishëm për formimin e fëmijëve. Aktualisht, është e vështirë të llogaritet norma e regjistrimit dhe të punohet për të rritur atë.</p> <p>Si në qytetin e Korçës ashtu edhe në njësitë e tjera administrative, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është më i ulët në raport me kapacitetet që këto kopshte disponojnë. Megjithatë, në kopshtet e qytetit të Korçës numri i fëmijëve të regjistruar është më afër kapacitetit në krahasim me kopshtet pranë njërive administrative. Si rezultat i analizës së numrit të fëmijëve të regjistruar në raport me kapacitetet pritëse të kopshteve, në kopshtet e Bashkisësë</p>		

Korçë norma e regjistrimit në raport me kapacitetin është 89%, ndërsa kemi edhe 11% vende vakante në raport me kapacitetin.

Si rezultat numrit të ulët të regjistrimeve, numri i grupeve të përziera në kopshtet publike të njësisë administrative është i lartë. Grupet e përziera kanë fëmijë të moshave nga 3 deri në 6 vjeç dhe formohen atëherë kur numri i fëmijëve nuk është i mjaftueshëm për të formuar grupe të I, II dhe të III. Numri më i lartë i grupeve të përziera ndodhen në kopshtet publike të njësisë administrative Bulgarec, përkatësisht 12 grupe nga 17 grupe në total. Numri i grupeve të para është më i lartë se numri i grupeve të dyta, çka do të thotë se për vitin 2019 regjistrimet e fëmijëve mund të kenë qenë më të mëdha se në vitin 2018. Mund të aludojmë se edhe në vitin 2017 regjistrimet kanë qenë më të larta se sa në vitin 2018, duke qenë se numri i grupeve të treta është më i lartë se numri i grupeve të dyta. Këtë konkluzion e mbështetet edhe analiza e kryer për numrin e fëmijëve në grupe.

Nuk është e qartë nëse numri i ulët i regjistrimeve vjen si arsye e numrit të ulët të fëmijëve, apo janë arsye të tjera si infrastruktura e kopshtit dhe konceptimi i arsimit parashkollor si jo i rëndësishëm për fëmijët. Për këtë arsye, është e vështirë të hartohet zgjidhja e duhur e këtij problemi.

## **ii Synimi i projektit**

Një mënyrë për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti në Bashki është duke bashkëpunuar me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Qendrat Shëndetësore. Bashkëpunimi me Zyrën e Gjendjes Civile do të mundësojë listën e fëmijëve të regjistruar në Gjendje Civile të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nga Qendrat Shëndetësore mund të merren listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nëpërmjet këtij projekti synohet që:

### **1. Rritja e regjistrimit dhe frekuencimit të kopshtit nga fëmijët.**

Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, pas përfundimit të regjistrimit të fëmijëve, mund të identifikojë fëmijët në moshë kopshti që nuk janë regjistruar. Në këtë mënyrë, drejtorët dhe mësueset e kopshteve mund të kryejnë takime me prindërit për të kuptuar arsyet e mosregjistrimit të fëmijëve të tyre në kopsht dhe informimin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmijëve. Në këtë mënyrë, synohet të rritet numri i fëmijëve që regjistrohen dhe ndjekin kopshtin.

### **2. Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera. Me rritjen e regjistrimit mund të ulët dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohen kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.**

### **3. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit. Duke pasur listat e fëmijëve në moshë kopshti sipas vendbanimit dhe moshës, Keshilltarja për**

Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçë, mund ta ketë më të lehtë të marrë vendimin për regjistrimin ose jo të fëmijëve në kopshtet ku kanë aplikuar.

### iii Niveli I ndërhyrjes

#### A: Ligjore

1. Përcaktimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për dërgimin e listave të fëmijëve në moshë kopshti mes:
  1. Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,
  2. Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore.

Marrëveshja do të përmbajë karakteristikat e listës që nevojitet (emri i fëmijëve, ditëlindja, vendbanimi), afatet e përgatitjes dhe dërgimit të saj, zyra/personi përgjegjës i secilit institucion për mbulimin e detyrimeve sipas marrëveshjes dhe mënyrën e dërgimit të listave.

#### B: Menaxheriale

1. Përcaktimi i një personi/zyre përgjegjëse nga secili institucion për dërgimin/marrjen e listave sipas rregullave të marrëveshjes së firmosur.

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Kryerja e takimeve mes aktorëve për theksimin e nevojës për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti; propozimin për bashkëpunim dhe identifikimi i problematikave (nëse ka) në realizimin e bashkëpunimit dhe gjetja e zgjidhjeve. Do të kryhen 2 takime:
  1. Takim me përfaqësues të Bashkisë dhe Keshilltares për Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçë, Gjendjes Civile në Korçë dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
  2. Takim me përfaqësues të Qendrave Shëndetësore dhe Keshilltares për Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçë,
2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes mes Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore;
3. Zbatimi i marrëveshjes. Keshilltarja për Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçë, merr listat dhe harton një listë të unifikuar të fëmijëve në moshë kopshti.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Listë vjetore të fëmijëve në moshë kopshti;
2. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve sipas zonave të banimit;
3. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;
4. Mundësia e uljes së grupeve të përziera dhe numrit të fëmijëve në këto grupe.
5. Mundësia e projeksionit të regjistrimit të fëmijëve në plan 3-vjeçar.



Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne BashkinëKorçë,</li> </ul>		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjendja Civile e Korçës</li> <li>Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile</li> <li>Drejtoria e Shendetit Publik Korce</li> </ul>					
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>							
N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktua l	Buxhet i Viti 2021	Buxhet i Viti 2022	Buxhet i Viti 2023	Tota l
1	Kryerja e takimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zevendes kryetare e Bashkise</li> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne BashkinëKorçë</li> </ul>		0			0
2	Hartimi dhe firmosja e marrëveshjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zevendes kryetare e Bashkise</li> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne BashkinëKorçë</li> </ul>		0			0
3	Zbatimi i marrëveshjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë</li> </ul>		0			0
				0			0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë			

Nr. 003	<b>Projekti:</b> Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	<b>Programi Buxhetor: 09120 -</b> Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni: 09</b>
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<p><b>I Situata</b></p> <p>Gjatë punës për diagnostikimin dhe përgatitjen e raporteve analitike të situatës të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Korçë u vu re një mosrakordim i të dhënave mes ZVAP, Bashkisë, Njësive Administrative dhe kopshteve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Mosrakordimi i të dhënave mes Bashkisë, ZVAP, Njësive Administrative dhe kopshteve u vu re në të dhëna si numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte, numri i mësuesve, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (me disavantazh social), kapaciteti akomoduesi kopshteve, etj. Mosrakordimi i të dhënave vështirëson diagnostikimin e situatës, evidentimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre dhe evidentimin e nevojës për ndërhyrje ose ndryshime në kopshte.</p> <p>Është e nevojshme të krijohet një sistem i unifikuar i të dhënave në kohë reale, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të gjithë aktorët të kenë akses te këto të dhëna dhe ndryshimi i tyre të jetë i menjëhershëm, pa kosto dhe njëkohësisht të gjitha databazat e aktorëve. Në këtë mënyrë, Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashki dhe ZVAP do të mund të bëjë parashikimet dhe planifikimet e nevojshme për ofrimin e një shërbimi efikas.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
<p>Një mënyrë për të pasur një unifikim të të dhënave në kohë reale është krijimi i një Platforme Digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin.</p> <p>Në këtë platformë mund të kenë akses:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashki mund të ketë akses te të gjitha të dhënat për çdo kopsht dhe është përgjegjëse për plotësimin e tyre.</li> <li>• Drejtoria e Kontrollit të Territorit mund të ketë akses në seksionin e gjendjes fizike të ndërtesave të kopshteve, për të plotësuar të dhënat për çdo kopsht, pas vlerësimit të kryer çdo vit.</li> <li>• Drejtoria e Kujdesit Social për të plotësuar të dhënat për fëmijët në nevojë për mbrojtje, në nevojë përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.</li> </ul> <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet rakordimi i të dhënave dhe koordinimi mes Bashkisë, Njësive Administrative, ZVAP dhe kopshteve dhe lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave që ka çdo kopsht. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që situata e arsimit parashkollor të jetë e qartë.</p>		

Struktura e Platformës do të përmbajë:

1. **Seksionin e të dhënave të përgjithshme** (emri i kopshtit, njësia administrative, adresa, nëse kopshti është publik ose privat, me ushqim ose pa ushqim, në godinë më vete ose jo, emri dhe kontaktet e drejtuesit, etj.)
2. **Seksioni i të dhënave të fëmijëve** (numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës, gjinisë dhe grupit ku bëjnë pjesë, numri i grupeve sipas llojeve, numri i fëmijëve në çdo grup, frekuentimi çdo muaj, etj.)
3. **Seksioni i të dhënave mbi organizmat që funksionojnë brenda kopshtit** (Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit).
4. **Seksioni i të dhënave të inventarit të kopshtit** (numri i mobilieve, vit i blerjes, gjendja e tyre, materialet didaktike dhe kancelarike, etj.)
5. **Seksioni i Shërbimeve Sociale** (numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe aftësi të kufizuar sipas vendbanimit/kopshtit, moshës, gjinisë, etj.)
6. **Seksioni i gjendjes fizike të godinës së kopshtit** (nevojat për mirëmbajtje dhe rikonstrukcion sipas prioritetit të ndërhyrjes, furnizimi me ujë, elektricitet, internet dhe ngrohje, numri i hapësirave, sipërfaqja e secilës prej hapësirave, etj.)
7. **Seksioni i Burimeve Njerëzore** (numri i mësueseve, mësueseve ndihmëse, stafit mbështetës, përvoja në punë, mosha dhe gjinia, etj.)

Nëpërmjet platformës mund të gjenerohen edhe analizat e situatës nga të dhënat e plotësuara. Për shembull, mund të llogaritet kapaciteti akomodues i kopshteve (duke marrë si referencë hapësirat në m<sup>2</sup> të kopshteve, numrin e klasave, etj.). Gjithashtu, mund të llogaritet numri i fëmijëve për një mësuese, norma e frekuentimit, norma e regjistrimit të fëmijëve, numri i karrigeve për 1 tavolinë, numri i shtretërve, numri i fëmijëve që flenë në kopsht dhe kërkesa për mobilje të reja në secilin prej kopshteve. Kështu, Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce do të ketë të qartë situatën e kopshteve dhe nevojës për ndërhyrje.

### iii Niveli i ndërhyrjes

#### A: Ligjore

1. Hartimi i një rregullore për mënyrën e plotësimit të Platformës Digjitale, institucionet që kanë akses, afatet e plotësimit ose të dërgimit të të dhënave të Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce, etj.
2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP mbi raportimin e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte për të shmangur raportimin direkt të kopshteve pranë ZVAP dhe si rrjedhim mosrakovardimin e shifrave.

#### B: Menaxheriale

1. Blerja e Platformës Digjitale për hedhjen e të dhënave individuale të kopshteve dhe gjenerimin e analizave. Bashkia mund të nënkontrakttojë një operator ekonomik për

<p>krijimin dhe mirëmbajtjen e Platformës Digjitale nëpërmjet procedurave të Prokurimit Publik.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Dërgimi i informacioneve të detajuara drejt Keshilltares për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe nga kopshtet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.</li> <li>Plotësimi i të dhënave nga Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe, Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Kontrollit të Territorit.</li> <li>Drejtoria e Kontrollit të Territorit kryen vlerësimin e ndërtesave të kopshteve çdo vit nëpërmjet vizitave në terren. Vlerësimi fillon në muajin Mars të çdo viti dhe përfundon në muajin Prill. Të dhënat e mbledhura nga inspektimet hidhen në Platformën Digjitale brenda muajit Maj.</li> <li>Gjenerimi i analizave të situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjes në nivel kopshti nga Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe</li> <li>Dërgimi i të dhënave të ZVAP dhe Njësitë Administrative.</li> </ol>	
<p><b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Blerja dhe mirëmbajtja e Platformës Digjitale;</li> <li>Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza. Pas blerjes së platformës, do të trajnohet stafi i cili do të jetë përgjegjës për përdorimin e Platformës;</li> <li>Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe, Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Kujdesit Social njihet me rregulloren.</li> </ol>	
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Platforma Digjitale me të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale;</li> <li>Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve;</li> <li>Zgjidhja e problemeve në kohë reale.</li> </ol>	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe;</li> <li>Drejtoria e Kontrollit të Territorit;</li> <li>Drejtoria e Prokurimeve;</li> <li>Drejtoria e Kujdesit Social.</li> </ul>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Operatori Ekonomik;</li> <li>ZVAP;</li> <li>NJA.</li> </ul>
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b></p>	

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Blerja dhe mirëmbajtja e Platformës Digjitale	Drejtoria e Prokurimeve/Operatori Ekonomik		0	0	0	0
2	Trajnimi I punonjësve	Operatori Ekonomik		0	0	0	0
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre	Kabineti I Kryetarit te Bashkise		0			0
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce				

Nr. 004	<b>Projekti:</b> Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		

## **I Situat**

Kopshtet në Bashkinë Korçë nuk hartojnë dhe zbatojnë një plan afatmesëm.

Plani Afatmesëm përmban:

- Misionin;
- Vizionin;
- Analiza e gjendjes;
- Përparësitë;
- Veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive;
- Produkti ose treguesit e arritjeve;
- Buxheti i përafërt.

Duke mos hartuar një plan afatmesëm, kopshtet nuk kanë një analizë të qartë të situatës, objektiva dhe një plan aktiviteteve për të arritur objektivat.

### **Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje**

Në Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020 *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”* përcaktohet kompetenca e hartimit të Planit Afatmesëm të IA dhe rubrikat e tij. Sipas tij, detyrën për ngritjen e grupit të punës nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (me kryetar drejtuesin e kopshtit) për hartimin e planit afatmesëm e ka drejtuesi i kopshtit.

## **ii Synimi i projektit**

Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me hartimin e planit afatmesëm dhe hartimi i planit në gjithë kopshtet e Bashkisë Korçë.

## **iii Niveli I ndërhyrjes**

### **A: Ligjore**

1. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku përcakton se kompetencat për monitorimin e hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm e ka Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë dhe NSHMAC si dhe drejtuesit e kopshteve duhet të raportojnë te ZVAP dhe Bashkia.

### **B: Menaxheriale**

1. Trainimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin e planit afatmesëm;

2. Zbatimi i Urdhrit nr. 31, neni 49 dhe 50 për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm në të gjitha kopshtet e Bashkisë Korçë.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Trainimi i drejtuesve të kopshteve/përgjegjësve të kopshteve për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm.
2. Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Kopshtet vendosin vetë objektiva dhe arrijnë ato;
2. Kopshtet funksionojnë jo vetëm si institucione në varësi të Bashkisë, por kanë edhe plane dhe objektiva të vetat që nxisin zhvillimin më të shpejtë të tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)  
 Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Trainimi i drejtuesve të kopshteve/ mësuesve përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce			0		0
2	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdokopsht	Drejtuesit/Përgjegjësit e kopshteve			0		0
					0		0

**f) Periudha e zbatimit:**  
 2022

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**  
 Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

Nr. 005	<b>Projekti:</b> Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<p><b>I Situata</b></p> <p>Aktualisht, nuk ekziston një metodë e unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve. Vlerësimi i brendshëm ka si synim të analizojë pikat e forta, mundësitë për përmirësime dhe faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë. Vetëvlerësimi, në asnjë rrethanë, nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Ai bëhet shumë më i fuqishëm, kur rezultatet transformohen në një plan zhvillimi. Plani duhet të identifikojë fusha dhe probleme që kërkojnë ndryshim dhe zgjidhje të reja, gjithashtu, duhet të identifikojë edhe objektivat, procedurat, burimet njerëzore dhe financiare për procesin e ndryshimit.</p> <p>Vetëvlerësimi ka qëllim matës, kur plani i veprimit ka qëllim përmirësimin e cilësisë. Transparenca e proceseve dhe rezultateve siguron automatikisht strategji komunikimi, nëpërmjet një publikimi aktiv.</p> <p>Qëllimi i metodologjisë së vlerësimit të brendshëm është të drejtojë, të orientojë, të lehtësojë mësuesit, organizmat kolegjalë të kopshtit, drejtuesit e kopshtit, për të vlerësuar veten, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjithëve aktorëve të kopshtit, sepse ata janë forca më e qenësishme, më e qëndrueshme e ndryshimit për përmirësimin e kopshtit.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i brendshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;</li> <li>2. kryhet çdo vit;</li> <li>3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi IA-së;</li> <li>4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmesh.</li> </ol>		
<p><b>ii Synimi i projektit</b></p> <p>Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen</p>		



fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.

### iii Niveli i ndërhyrjes

#### A: Ligjore

1. Nxjerrja e një udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm të kopshtit. ASCAP ka hartuar tashmë udhëzuesin metodologjik për vlerësimin e brendshëm të shkollës.
2. Nxjerrja e Urdhrit nga Kryetari i Bashkisë, për realizimin e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshtit.

#### B: Menaxheriale

1. Bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm (Urdhër nr. 54, datë 26.05.2020 “Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës”) ASCAP harton pyetësorë për mësuesit, prindërit dhe drejtorët e kopshteve/përgjegjësit e kopshteve për të kryer vlerësimin e brendshëm;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për vlerësimin e brendshëm bazuar mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm të Shkollës/Kopshtit nga ASCAP;
3. Drejtuesit e kopshteve trajnojnë stafin arsimor të kopshtit dhe organizmat e kopshtit (Këshillin, Bordin dhe Komisionin) për kryerjen e vlerësimit të brendshëm;
4. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël të mashose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës;
5. Koordinator i grupit, me ndihmën e koordinatorit të ZVAP, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm.
6. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore.

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga ASCAP;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga ASCAP;
3. Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshteve;
4. Organizimi i fokus grupeve;
5. Analiza dhe raportimi i rezultateve.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve duke krijuar disa indikatorë të matshëm;
2. Nxitja për vet-përmirësimi mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve;

### 3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</li> </ul>	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZVAP</li> <li>• ASCAP.</li> </ul>
---	--

#### e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

N r	Emertimi	Pergjegjes	FaktAktua l	Buxhet i Viti 2021	Buxhet i Viti 2022	Buxhet i Viti 2023	Tota l
1	Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve	ASCAP		0			0
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	ASCAP		0			0
3	Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0			0

4	Organizimi i fokus grupeve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0			0
5	Analiza dhe raportimi i rezultateve	Koordinator i Grupit dhe ZVAP		0			0
				0			0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2022-2023				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce			

Nr. 006	<b>Projekti:</b> Regjistrimi në kopsht sipas banimit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Aplikimet për regjistrimin e fëmijëve bëhen pranë kopshteve nga prindërit. Dokumentet për aplikim janë: certifikata familjare, certifikata e banimit dhe për kopshtin me ushqim kërkohet edhe vërtetim pune për njërin nga prindërit. Dokumentet shqyrtohen nga mësueset, të cilat krijojnë edhe dosjet individuale për çdo fëmijë, por nuk dërgojnë listën e fëmijëve të regjistruar në kopsht pranë Bashkisë.</p> <p>Nga analiza e arsimit parashkollor në Bashkinë Korçë u vu re se në terma të kapacitetit akomodues të kopshteve ka ndryshime të mëdha nga njëri kopsht në kopshtin tjetër. Një kopsht në qytetin e Korçës është mbi kapacitet me 29 fëmijë (Kopshti 3), ndërsa një tjetër ka 60 vende bosh (Kopshti 6). E njejta situatë vihet re edhe në disa prej njësive administrative. Një prej arsyeve që shpejgon këtë fenomen është fakti se kopshtet që ndodhen në qendrën e qytetit janë më të preferuara nga prindërit, ndaj ata nuk i regjistrojnë fëmijët në kopshtin që i takon sipas zonës së banimit, por në kopshtin që preferon.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte shkakton mbipopullim të disa kopshteve dhe nën popullim të kopshteve të tjera. Mbipopullimi i kopshteve shkakton pengesa në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, ndërsa nënpopullimi bën që hapësirat, në të cilat është investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.</p>		

## ii Synimi i projektit

Për të siguruar shpërndarjen e barabartë të fëmijëve në kopshte është e rëndësishme të sigurohet që cilësia e shërbimit në të gjithë kopshtet është e njëjtë dhe regjistrimi kryhet sipas zonës së banimit dhe jo preferencave të prindërve. Ky projekt përqendrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit nëpërmjet përcaktimit të një rregulloreje, e cila do të ndiqet nga të gjitha kopshtet.

## iii Niveli i ndërhyrjes

### A: Ligjore

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet pranë zonës së tyre të banimit;

Hartimi i një rregulloreje që përcakton procedurën, aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe

### B: Menaxheriale

Një model i rregullores mund të jetë si mëposhtë:

1. Prindërit përpos dokumentave që dorëzojnë për regjistrimin e fëmijëve në kopsht, duhet të dorëzojnë dhe Certifikatën e vendbanimit. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 1 - 10 qershor;
2. Kopshti merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Keshilltares për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe. Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga kopshti deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
3. Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë kopshti dhe i dërgon kopshteve listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në fund të qershorit. Gjithashtu, identifikon nëpërmjet listës së fëmijëve në moshë kopshti, fëmijët që nuk janë regjistruar ende në kopsht;
4. Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron kopshtin në të cilin fëmijës i takon të regjistrohet;
5. Pasi regjistrimet përfundojnë, sipas udhëzimeve të Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe, drejtuesit/mësuesit e kopshteve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të identifikuar arsyet e mosregjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmija. Kjo detyrë mund t'i përcaktohet dhe një punonjësi tjetër, si për shembull grupeve të terrenit që kanë si detyrë identifikimin e fëmijëve në situatë rruge.

## iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit;
2. Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit;
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit;
4. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht;
5. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit;
2. Shpërndarje e njejtë e regjistrimit të fëmijëve;
3. Rritje e numrit të regjistrimeve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brendabashkisë)

- Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe
- Kryetari i Bashkisë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktua l	Buxhet i Viti 2021	Buxhet i Viti 2022	Buxhet i Viti 2023	Tota l
1	Nxjerrja e Urdhrit për regjistrimin sipas zonave të banimit	Kryetari i Bashkisë		0			0
2	Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit	Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe		0			0

3	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0			0
4	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce Zyra e GJC Drejtoret e kopshteve		0			0
5	Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce/drejtues/mësues/Grupet e Terrenit		0			0
				0			0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce			

Nr. 007	<b>Projekti:</b> Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor është e ulët. Në Njësitë Administrative numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët. Ky fakt mund të vijë si pasojë e infrastrukturës së kopshteve dhe/ose mentalitetit të prindërve mbi arsimin parashkollor si një faktor jo i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		

Mospërfshirja e komunitetit në aktivitete ose çështje të rëndësishme të arsimit parashkollor është një tregues i mungesës së interesit të komunitetit për këto çështje, duke i konsideruar si çështje të një rëndësie jo shumë të madhe. Ky mentalitet mund të jetë një arsye e numrit të ulët të regjistrimit të fëmijëve në kopsht në Njësitë Administrative. Gjithashtu, nëse arsimi parashkollor nuk konsiderohet si prioritet nga komuniteti, atëherë mund të ndodhë të mos jetë një prioritet për vetë Bashkinë.

Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njësite Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është më i lartë se numri i grupeve vetë I, II dhe III dhe numri i fëmijëve në këto grupe është i lartë. Ky fakt shkakton vështirësi në edukimin dhe menaxhimin e fëmijëve.

Gjithashtu, për shkak të çështjeve dhe problemeve më madhore të Bashkisë dhe fokusit të saj te Programe Strategjike të Buxhetit, problemet e kopshteve gjatë hartimit të buxhetit mund të mos adresohen ashtu siç duhet dhe përpasojë buxheti i vendosur për arsimin parashkollor mund të mos jetë i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve si rikonstruksioni i kopshteve apo ndërtimi i kopshteve të reja.

## ii Synimi i projektit

Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen për sa i përket arsimit parashkollor.

Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet:

1. **Zhvillimi i fëmijëve.** Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten;
2. **Informimi i komunitetit.** Këto aktivitete është mirë që të ndërthuren dhe me sesione të shkurtra informuese për rëndësinë që ka arsimi parashkollor te formimi i fëmijëve ose të jenë kryesisht me natyrë informuese. Përveç aktivizimit të fëmijëve, komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësuesëve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimi dhe nevojën që ekziston që kykomunitet të jetë më aktiv në çështje të arsimit parashkollor. Në këtë mënyrë, mund të llobohet prej tyre gjatë hartimit të buxhetit në Bashki për të rritur buxhetin e vendosur për kopshtet;
3. **Rritja e regjistrimeve.** Shumë prindër, duke e konsideruar kopshtin si një nivel jo të rëndësishëm të arsimit nuk i regjistrojnë ata në kopsht. Arsye të tjera të mosregjistrimit mund të jetë mosnjohja e ambienteve të kopshteve, mësueset dhe stafin e kopshteve. Nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshti, ata do të njihen me ambientet,

mësueset, mënyrat e mësimdhënies, përfitimet e fëmijës nga kopshti dhe në këtë mënyrë synohet të rritet norma e regjistrimit;

4. **Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera.** Me rritjen e regjistrimit mund të ulet dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohen kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.

### iii Niveli i ndërhyrjes

#### A: Ligjore

#### B: Menaxheriale

1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikojnë aktivitetet. Për të rritur sa më shumë partneritet me komunitetin por edhe motivimin e Këshillit të Prindërve për të qenë aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kopshtit, duhet që Bashkia të njohë disa pika kyçe të zonës ku është kopshti si p.sh.
  1. *Cilat janë karakteristikat kyçe dhe pikat e forta të komunitetit ku ndodhet kopshti?*
  2. *Çfarë mund të bëni ju dhe çfarë mbështetje kërkon ju për të mbështetur kopshtin në fushatë tilla si disiplinimi pozitiv, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit në moshë të hershme?*
  3. *A ka partneritete të ndërtuara mes kopshtit dhe kulturave të ndryshme të komunitetit?*
2. Kalendarit i aktiviteteve dërgohet tek Këshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce
3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve.

#### C:Infrastrukturore

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

Shtator	Tetor-Dhjetor	Janar-Mars (vetëm për kopshtet e NJA)	Prill-Gusht(vetëm për kopshtet e NJA)
Prindërit dhe mësuesit takohen për të diskutuar:	<b>Kopshti:</b> -Planifikon aktivitetet bazuar te nevojat e fëmijëve dhe komunitetit.	Në bashkëpunim me kopshtin dhe bashkinë, organizohen takime me komunitetin për të krijuar <b>grupin e vullnetarëve</b> (prindër,	-Kopshti ofron aktivitete në ambient të hapur;



1. Aktivitetet që do realizohen gjatë vitit;	<b>Prindërit:</b>	studentë, dhe pjestarë të tjerë të komunitetit).	-Komuniteti mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete;	
2. Nevojat që kanë fëmijët dhe komuniteti;		-Marrin pjesë tek aktivitetet që ata kanë shprehur dëshirën të jenë pjesëmarrës;	Grupiivullnetarëve merr pjesënë organizimin e aktivitetevetëardhshme.	-Prindërit ndihmojnë fëmijën nën djekjen e detyrave.
3. Kopshti rritin formimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Prindërve.		-Informohen nga kopshti nëmënyrë të vazhdueshme për planin që zhvillon kopshti.		

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;
2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht;
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Komuniteti
- Kopshti
- Universiteti “Fan S. Noli”
- Gjinnazet

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0
2	Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0

3	Takim me Këshillin e Prindërve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0
4	Organizimi i aktiviteteve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe			

Nr. 008	<b>Projekti:</b> Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve për akomodimin e aktiviteteve të fëmijëve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor është e ulët. Në Njësitë Administrative numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Mospërfshirja e komunitetit në aktivitete ose çështje të rëndësishme të arsimit parashkollor është një tregues i mungesës së interesit të komunitetit për këto çështje, duke i konsideruar si çështje të një rëndësie jo shumë të madhe. Ky mentalitet mund të jetë një arsye e numrit të ulët të regjistrimit të fëmijëve në kopsht në Njësitë Administrative. Gjithashtu, nëse arsimit parashkollor nuk konsiderohet si prioritet nga komuniteti, atëherë mund të ndodhë të mos jetë një prioritet për vetë Bashkinë.		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen për sa i përket arsimit parashkollor.		
Ky projekt synon hartimin e një marrëveshjeje me Qytezën e Fëmijëve në Korçë për të organizuar aktivitetet në hapësirat e saj. Aktivitetet dhe programet e hapësirës 3-6 vjet të organizuara në Qytezën e Fëmijëve do të kenë objektiv kryesor:		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimin e inteligjencës nëpërmjet programeve edukative</li> <li>• Bashkëpunimi në grup dhe aftësia për t'u socializuar me njëri-tjetrin</li> </ul>		

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i aftësive motorike</li> <li>• Njohja e metodave inovative që përmban programi</li> <li>• Zhvillimi i kreativitetit</li> <li>• Njohja e elementëve të ndryshëm siç janë: kafshët dhe habitatet e tyre përkatëse, ngjyrat, format.</li> </ul>																							
<p><b>iiiNiveli i ndërhyrjes</b></p> <p><b>A: Menaxheriale</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Personi përgjegjës për arsimin parashkollor Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe harton një marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve për organizimin e aktiviteteve të kopshteve.</li> <li>2. Personi përgjegjës i arsimit parashkollor harton kalendarin e aktiviteteve për të gjithë kopshtet, bazuar në datat që kopshtet kanë dërguar.</li> </ol>																							
<p><b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve</li> <li>2. Planifikim i aktiviteteve.</li> </ol>																							
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;</li> <li>2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht;</li> <li>3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.</li> </ol>																							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe</li> </ul>				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komuniteti</li> <li>• Kopshti</li> <li>• Universiteti “Fan S. Noli”</li> <li>• Gjimnazet</li> </ul>																			
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emertimi</th> <th>Pergjegjes</th> <th>FaktAktual</th> <th>Buxheti Viti 2021</th> <th>Buxheti Viti 2022</th> <th>Buxheti Viti 2023</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve</td> <td>Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit</td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>								Nr	Emertimi	Pergjegjes	FaktAktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total	1	Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0
Nr	Emertimi	Pergjegjes	FaktAktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total																
1	Marrëveshje me Qytezën e Fëmijëve	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit		0	0	0	0																

2	Planifikimiaktiviteteve.	Drejtuesi/Përgjegjësiikopshtit		0	0	0	0
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce				

### Risqet

Risku	Mitigimi
Qendrat Shëndetësore dhe Zyra e Gjendjes Civile kanë të dhëna mbi fëmijët në moshë kopshti të ndryshme nga njëra-tjetra dhe/ose të mos kenë të dhëna për të gjithë fëmijët. Në këtë rast rrezikohet që Bashkia Korce të mos evidentojë listën e fëmijëve në moshë kopshti.	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce ngre një grup pune për unifikimin e të dhënave të marra nga Qendrat Shëndetësore dhe Gjendja Civile. Unifikimi i të dhënave do të bazohet te zona e banimit të fëmijës, emri dhe mbiemri i fëmijës dhe datëlindja. Grupi i punës bashkëpunon vazhdimet me Qendrat Shëndetësore për verifikimin e të dhënave.
Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit mund të detyrojë prindërit të regjistrojnë fëmijët në kopshte që nuk janë pranë zonës ku ata banojnë realisht, por në kopshte ku kanë zonën e banimit zyrtarisht.	Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë që fëmija e tyre të regjistrohet pranë zonës së tyre reale të banimit, nëse mund ta vërtetojnë në mënyrë zyrtare nëpërmjet një kontrate qiraje, kontrate pune, hipoteka e shtëpisë, etj.

## 2.4 Organizmat e Institucionit

### Arsimor

#### 2.4.1 Këshilli i Prindërve

#### Informacion i përgjithshëm

Bazuar në Urdhrin Nr. 31, dt.28/01/2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kopshtet krijojnë këshillin e prindërve.

Urdhri Nr. 31, dt.28/01/2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë".

- **Neni 89/pika 4:** Këshilli i Prindërve të institucionit përbëhet nga 6-9 prindër të zgjedhur nga këshillat e klasave. Numri i prindërve në këshillin e prindërve përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit arsimor. Në mbledhjen e parë të këshillit, kryetari i tij zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të këshillit, midis kandidatëve për këtë detyrë. Neni 89/pika 6: Kryetari dhe anëtarët e këshillit të prindërve nuk duhet të jenë në konflikt interesi me drejtorin e institucionit, nuk duhet të kenë precedentë penalë dhe të mos jenë në forume të partive politike.
- **Neni 90:** Mbledhjet dhe vendimet e këshillit të prindërve të institucionit arsimor. **90/pika 1:** Këshilli i prindërve mbledhet të paktën tre herë në vit. Mbledhje të tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të këshillit të prindërve ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. **90/pika 2:** Mbledhja e këshillit zhvillohet kur merr pjesë shumica e thjeshtë e anëtarëve të tij, përndryshe shtyhet.
- **Neni 92/pika 2:** Këshilli i prindërve të klasës zgjidhet për çdo klasë, brenda 10 ditëve, nga data e fillimit të vitit shkollor, me përkujdesjen e mësuesit kujdestar. Për këtë zhvillohet mbledhja e përgjithshme e prindërve të nxënësve të klasës, ku me shumicë votash zgjidhet këshilli i prindërve të klasës (3-5 persona). Kryetari i këshillit të prindërve të klasës zgjidhet nga ky këshill.

Nga 10 kopshte që janë intervistuar, rezulton se të gjitha kopshtet e kanë themeluar Këshillin e Prindërve.

Sipas analizës së të dhënave, vihet re se, numri minimal i anëtarëve të këshillit të prindërve është 5, numri mesatar është 9, ndërsa numri maksimal është 12.

Numri i anëtarëve të këshillit të prindërve, që i përkasin gjinisë "femër" është më i lartë, në krahasim me numrin e anëtarëve të gjinisë "mashkull", në kopshtet e qytetit të Korçës, ky raport është rreth 8 anëtarë të gjinisë "femër" me 1 anëtar të gjinisë "mashkull". Ndërkohë për sa ju takon mbledhjeve të këshillit: numri minimal i mbledhjeve të këshillit të prindërve është 2, mesatarja e mbledhjeve është 3 dhe maksimumi i mbledhjeve është 4.

Këshilli i Prindërve ngrihet cdo fillim viti me urdhër të drejtuesit/përgjegjës të kopshtit. Këshilli i Prindërve të kopshtit nuk monitorohet nga Bashkia, por vetëm nga drejtuesi/përgjegjësi i kopshtit.

*Objektiva kryesore:*

Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

*Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet sipas Udhëzimit Nr. 31
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit

*Indikatorët e performancës*

Kodi	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare				
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare				
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare				
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare				
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	Këshillit të Prindërve							
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare				
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare				
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare				
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare				
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Fshat	Vlere	Mesatare				
014	Numri i aktiviteteve të	Periferi	Vlere	Mesatare				

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë							
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Qender	Vlere	Mesatare				
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare				
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare				
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare				
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare				
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare				
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të	Qender	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	Këshillit të Prindërve							
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Shumatore				
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Shumatore				
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Shumatore				

#### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periodhe
010	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0
009	Themelimi i Këshillit të Prindërve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0

Listae projekteve

<p>Nr. 009</p>	<p><b>Projekti:</b> Themelimi i Këshillit të Prindërve</p>	<p><b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</p> <p><b>Funksioni:</b> 09</p>
<p><b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b></p>		
<p><b>I Situata</b></p> <p>Gjatë analizës së arsimit parashkollor në Bashkinë e Korçës janë intervistuar 10 kopshte në qytetin e Korçës. Këto kopshte e kishin themeluar Këshillin e Prindërve. Megjithatë, nga të dhënat që kemi nga Bashkia, përgjegjës për themelimin e Këshillit të Prindërve janë drejtuesit/përgjegjësit e kopshteve dhe bashkia nuk monitoron themelimin dhe vazhdimësinë e tyre.</p>		
<p><b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b></p>		
<p>NëBashkinë e Korçës 28 nga 43 kopshte gjenden në godinat e shkollave. Këto kopshte menaxhohen nga drejtuesit e shkollës. Mënyra se si themelohet Këshilli I Prindërve në këto kopshte dhe si funksionon në vazhdim nuk është e qartë. Gjithashtu, vihet re që temat që diskutohen shpesh here lidhen edhe me përgjegjësitë cilat nuk I zgjidh dot as Këshilli dhe as vetëm kopshti.</p>		
<p><b>ii Synimi i projektit</b></p> <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht dhe ndarja e tij nga Këshilli i Shkollës;</li> <li>2. Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në Këshillat e Prindërve. Sipas Udhëzimit nr. 31, Këshilli mund të ketë 6-9 anëtarë. Jo të gjitha kopshtet e përmbushin këtë kriter. Bashkia nëpërmjet monitorimit të sa jgjatë themelimit do të sigurojë përmbushjen e këtij standardi (bëjnë përjashtim kopshtet të cilat kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar).</li> </ol>		
<p><b>iii Niveli i ndërhyrjes</b></p> <p><b>A: Ligjore</b></p> <p><b>B: Menaxheriale</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kopshtet themelojnë Këshillin e Prindërve dhe i dërgojnë listën e anëtarëve Keshilltares per Arsimin Parashkollor ne BashkinëKorce sipasUdhëzimit nr. 31;</li> <li>2. Kopshtet që ndodhen në godinat e Shkollave themelojnë Këshillin e Prindërve të mëvetësishëm nga Këshilli i Prindërve të Shkollës;</li> </ol>		

<p>3. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce monitoron procesin e themelimit të Këshillave të Prindërve për të siguruar që çdo kopshti përmbahet Udhëzimit nr. 31 dhe monitoron mbarëvajtjen e Këshillit të Prindërve për gjatë vitit.</p>																																							
<p><b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht;</li> <li>Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve.</li> </ol>																																							
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 31.</li> </ol>																																							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</li> </ul>				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p>																																			
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Emertimi</th> <th>Pergjegjes</th> <th>Fakt Aktual</th> <th>Buxheti Viti 2021</th> <th>Buxheti Viti 2022</th> <th>Buxheti Viti 2023</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht</td> <td>Drejtuesit/përgjegjësit e kopshteve</td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve</td> <td>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>								Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total	1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht	Drejtuesit/përgjegjësit e kopshteve		0	0	0	0	2	Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0					0	0	0	0
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total																																
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht	Drejtuesit/përgjegjësit e kopshteve		0	0	0	0																																
2	Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0																																
				0	0	0	0																																
<p><b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023</p>				<p><b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</p>																																			

Nr. 010	<b>Projekti:</b> Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
---------	--	--

		<b>Funksioni: 09</b>
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bordin e Prindërve, të parashikuar sipas legjislacionit në fuqi (Neni 89/pika 4: Këshilli i Prindërve të institucionit përbëhet nga 6-9 prindër të zgjedhur nga këshillat e klasave). Ndërkohë, mungon informacion mbi përqindjen e numrit të prindërve që marrin pjesë në takime, për të kuptuar sa i rëndësishëm është mbledhja e këtij Këshilli për të sjellë ndryshime në kopsht.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Duke qenë se Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor dhe nëse funksionon vetëm formalisht, atëherë është e vështirë që shumë probleme të kopshteve, që kërkojnë edhe buxhet të madh, të jenë prioritet për Këshillin Bashkiak ose Bashkinë. Për këtë arsye është e nevojshme të trajnohen anëtarët e Këshillit të Prindërve çdo vit, në mënyrë që të adresojnë dhe ndjekin siç duhet problematikat e kopshtit.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
Nëpërmjet këtij projekti synohet:		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohet përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.</li> </ol>		
<p>Për të fuqizuar Këshillin e Prindërve shihet tejet i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të Këshillit dhe rruga që ndiqet për t'i dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga Këshilli.</p>		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>		
<b>A: Ligjore</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i një protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të Këshillit dhe rrugës që Këshilli ndjek për t'ihënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje. Detajimi nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm siç është udhëzimi nr. 25 për Bordin e Kopshtit, që edhe këshilli për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje nga bashkia, të raportojë pranë bashkisë.</li> </ol>		
<b>B: Menaxheriale</b>		

<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve. Ky trajnim do të organizohet së bashku me trajnimin për Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit kështu që nuk do të ketë kosto shtesë;</li> <li>2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për t'i trajnuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;</li> <li>3. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Këshillin e Prindërve.</li> </ol>							
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që Këshilli i Prindërve ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje;</li> <li>2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës ndiqet nga Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce;</li> <li>3. Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve nga drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës.</li> </ol>							
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve;</li> <li>2. Protokoll i unifikuar mbi mënyrën se si themelohet Këshilli i Prindërve, si raportohen çështjet që diskutohen gjatë mbledhjeve dhe si marrin zgjidhje.</li> </ol>							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</li> </ul>				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZVAP</li> <li>• Universiteti "Fan S. Noli"</li> <li>• OJF</li> </ul>			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Akt ual	Bux het i Viti 2021	Bux het i Viti 2022	Bux het i Viti 2023	Tota l
1	Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë		0			0

		Korce/ZVAP					
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës	Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe		0	0	0	0
3	Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Drejtuesit e kopshteve/Mësuesi përgjegjës		0	0	0	0
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023		<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçe					

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësuesve përgjegjës për të kryer trainimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Këshillit të Prindërve dhe për të themeluar Këshillin e Prindërve, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë.	Brenda vitit 2021-2023 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 30 për punësimin e drejtorëve për kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh.

### 2.4.2 Bordi i Kopshtit

#### Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet që ndodhen në godinat e shkollave Bordi i Kopshtit është i integruar në Bordin e Shkollës. Në këtë rast fokusi i Bordit nuk është shumë i përqendruar në menaxhimin dhe problemet e kopshteve. Në NJA vetëm 3 kopshte janë në godinë më vete, ndërsa 33 kopshtet e tjera ndodhen në godinën e shkollës.

Ndërsa kopshtet në qytet janë të gjitha në godinë më vete. Për këtë arsye, në këto kopshte, Bordi i Kopshtit ka një rol kyç në menaxhimin e kopshtit. Zakonisht ka në përbërjen e tij persona që kanë iniciativën për të ndihmuar edhe nga ana financiare. Ka përfaqësues në çdo klasë dhe zakonisht përbëhet nga 3-5 anatarë. Në një nga kopshtet e Bashkisë Korçë me ndihmën e Bordit u rregullua e gjithë infrastruktura e kopshtit brenda 1 viti. Bordi i Kopshtit ndihmon për organizimin e festave dhe aktiviteteve të ndryshme që organizohen në kopsht. Buxheti i nevojshëm mblidhet dhe menaxhohet nga Bordi. Kuota e vendosur është jo më shumë se 200 leke të reja dhe për ata fëmijë që nuk kanë mundësi ekonomike ky shpenzim mbulohet nga Bordi. Ka raste që në Bordin e Kopshtit mungojnë përfaqësues nga komuniteti ose nuk janë në vazhdimësi të institucionit dhe nuk janë pjesëmarrës të rregullt. Bordi organizon trajnime me tematika të ndryshme në formë loje për fëmijët në bashkëpunim edhe me Qendrën Shëndetësore ose dentistët e zonës, me praninë edhe të prindërve. Vendoset nga drejtuesja e institucionit në planin vjetor, tematika dhe data e trajnimit. Çdo javë në kopshte organizohen nga prindër të ndryshëm takime me fëmijët ku shpjegojnë apo gatuajnë diçka në formë loje.

#### Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

#### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht
2	Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki

#### Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare				
024	Numri i mbledhjeve të	Periferi	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	Bordit të Kopshtit							
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare				
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare				
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare				
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare				
022	Mbledhje të KB mbi arsimin parashkollor ku ka marrë pjesë Grupi Përfaqësues ndaj mbledhjeve totale mbi arsimin parashkollor	Bashki	Vlere	Shumatore				
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të	Fshat	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	ngritura nga Bordi i Kopshtit							
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare				
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare				
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare				
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare				
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare				
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës	Fshat	Vlere	Shumatore				
019	Numri i kopshteve që	Periferi	Vlere	Shumatore				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës							
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës	Qender	Vlere	Shumatore				
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Shumatore				
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Periferi	Vlere	Shumatore				
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Fshat	Vlere	Shumatore				

## Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total peridhe
013	Ngritja e një strukture lidhëse mes	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor			0	0	0

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periudhe
	Bashkisë dhe kopshteve	ne Bashkinë Korce					
012	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0
011	Themelimi i Bordit të Kopshtit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0

*Listae projekteve*

<b>Nr.</b> 011	<b>Projekti:</b> Themelimi i Bordit të Kopshtit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Në 13 kopshtet e qytetit të Korçës Bordi i Kopshtit është i themeluar dhe luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kopshtit. Ndërsa, 33 kopshte në NJA që ndodhen brenda godinave të arsimit bazë, kanë të integruar Bordin e Kopshtit në Bordin e Shkollës. Pra, në 36 kopshte që ndodhen në NJA, vetëm 3 kopshte e kanë Bordin e Kopshtit funksionalvetëm për kopshtin.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit në përmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Megjithatë, jo të gjitha kopshtet e kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Gjithashtu, nuk shpjegohet qartë se cila është procedura që ndiqet nga Bordi, për zgjidhjen e problemeve që ngrihen në të.</p>		

Një problematikë e hasur në disa prej kopshteve të Njësive Administrative është që nuk kanë drejtues. Është Drejtuesi i Shkollës së Arsimit Bazë që luan rolin e drejtuesit të kopshtit. Si pasojë, disa kopshte e kanë Bordin e tyre të integruar me Bordin e Shkollës. Në këtë rast, për shkak të vëmendjes më të madhe që i kushtohet arsimit bazë, dhe për faktin që numri i nxënësve, mësuesve dhe si pasojë edhe i çështjeve që duhen trajtuar është më i madh në arsimin bazë, problemet e kopshteve mund të lihen në hije.

## ii Synimi i projektit

Është e nevojshme të ndërhyet për të themeluar Bordin e Kopshtit në kopshtet që ende nuk e kanë themeluar dhe të ndahet Bordi i Kopshtit nga ai i Shkollave.

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Themelimi i Bordit në të gjitha kopshtet.
2. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga ai i Shkollave.

## iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht

## b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Bordit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht;
2. Rritja e monitorimit të Bordit të Kopshti nga ana e Bashkisë.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce;
- Kryetari i Bashkisë.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Bordi i Kopshteve
- Drejtuesit e kopshteve.

## e) Shpenzimet e llogaritura (përçdoaktivitetetëmësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Themelimi i Bordit të	Keshilltarja per Arsimin		0	0	0	0

	Kopshtit në çdo kopsht	Parashkollor ne Bashkinë Korçe					
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe			

Nr. 012	<b>Projekti:</b> Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	<b>Programi Buxhetor: 09120 -</b> Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni: 09</b>
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Gjatë analizës vihet re, qënë disa kopshte Bordi i Kopshtit nuk është krijuar ende i mëvetësishëm. Gjithashtu edhe në kopshte që është formuar vihet re fakti që jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bord. Edhe në kopshtet në të cilat është krijuar Bordi, numri i takimeve nuk është shumë i shpeshtë që të tregojë impaktin e tij në jetën e kopshtit. Për sa i përket mbledhjes së bordit të kopshtit, ashtu si mbledhja e këshillit të prindërve, në disa kopshte realizohet më pak nga sa është e parashikuar sipas akteve ligjore.</p> <p>Ka një diferencë mes funksionimit të Bordit në qytetin e Korçës dhe NJA. Në qytet Bordi është shumë më aktiv dhe pjesëmarrës në aktivitete të kopshtit, në përmirësimin e shërbimit dhe gjetjen/ofrimin e zgjidhjeve të problematikave të ndryshme.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Bordi i Kopshtit ka sisynim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit në përmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Për këtë arsye është e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e Bordit të Kopshtit, sidomos në kopshtet e NJA.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
Nëpërmjet këtij projekti synohet:		

1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

### iii Niveli i ndërhyrjes

#### A: Menaxheriale

1. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce në bashkëpunim me anëtarë të Bordeve të Kopshteve të qytetit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Bordit të Kopshtit;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Bordit për t'i trajnuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre dhe për të ndarë me ta shembullin pozitiv të Bordit të Kopshteve të qytetit;
3. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce dhe anëtarë të Bordit të Kopshteve të qytetit të Korçës, ndjekin dhe asistojnë drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës në trajnimet që ata kryejnë me Bordin e Kopshtit.

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce dhe anëtarët e Bordit të Kopshteve të qytetit;
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF
- Universiteti “Fan S. Noli”

### e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Trajnimi i drejtuesve të	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor		0	0	0	0

	kopshteve/mësuesve përgjegjës	ne Bashkinë Korçe					
2	Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Drejtuesit e Kopshteve		0	0	0	0
				0	0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe			

Nr. 013	<b>Projekti:</b> Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Edhe pse në pjesën më të madhe kopshtet e Bashkisë Korçë e kanë ngritur Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, nuk është e qartë se si temat që diskutojnë dhe problematikat që evidentojnë adresohen në Bashki për të gjetur zgjidhje.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Në një pjesë të kopshteve duket sikur organizmat e mësipërm funksionojnë vetëm formalisht. Kjo do të thotë se nevojat e kopshteve të evidentuara në takime nuk adresohen në Bashki dhe nuk diskutohen në Këshillin e Bashkisë për të gjetur zgjidhje. Për këtë arsye është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi mes këtyre organizmave dhe Bashkisë.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
<p>Për anëtarët e Këshillit, Bordit dhe Komisionit të kopshteve pranë NJA, mund të jetë e vështirë pjesëmarrja në takimet e Këshillit të Bashkisë kur diskutohet buxheti apo planifikohen investimet. Duke munguar një zë në këto takime që thekson problematikat e kopshteve, shihet e vështirë gjetja e zgjidhjeve të tyre.</p> <p>Ndaj, nëpërmjet këtij projekti synohet që të krijohet një grup përfaqësues me pjesëmarrës nga Këshillat e Prindërve, Bordeve të Kopshteve dhe Komisioneve nga të gjitha kopshtet e Bashkisë, që do të ketë kontakte me të gjitha organizmat në gjithë kopshtet dhe do të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak sa herë diskutohen çështje që lidhen me arsimin parashkollor.</p>		

Në këtë mënyrë synohet që të ngrihet zëri mbi problematikat e kopshteve dhe të gjenden zgjidhje për to.

### iii Niveli i ndërhyrjes

#### A: Ligjore

1. Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce krijon një rregullore mbi të drejtat dhe detyrat e Grupit Përfaqësues, mënyrën e raportimit, mënyrën e njoftimit për mbledhje, etj.

#### B: Menaxheriale

1. Sapo në të gjitha kopshtet janë themeluar Këshilli, Bordi dhe Komisioni, krijohet Grupi Përfaqësues. Grupi Përfaqësues nuk ka minimum dhe maksimum anëtarësh. Anëtarët mund të jenë nga çdo kopsht apo organizëm dhe pjesëmarrja në të është vullnetare;
2. Kur ky grup formohet, drejtuesit e kopshteve (të trajnuar tashmë nga Bashkia) informojnë anëtarët mbi të drejtat, detyrimet dhe protokollin e adresimit të një çështjeje.

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i rregullores për ngritjen e Grupit Përfaqësues;
2. Krijimi i Grupit Përfaqësues;
3. Informimi i anëtarëve të Grupit nga drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrimet.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e një grupi përfaqësuesi 3 organizmave të kopshteve, që do të përfaqësojë kopshtet në nivelin vendor;
2. Theksimi më i madh i problematikave të kopshteve në Bashki

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Universiteti “Fan S. Noli”
- OJF

### e) Shpenzimet e llogaritura (përçdoaktivitet më sipërm pika iv)



N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktua l	Buxhet i Viti 2021	Buxhet i Viti 2022	Buxhet i Viti 2023	Tota l
1	Hartimi i rregullores për ngritjen e Grupit Përfaqësues	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce			0		0
2	Krijimi i Grupit Përfaqësues	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce			0	0	0
3	Informimi i anëtarëve të Grupit	Drejtuesit e kopshteve/Mësuesitpërgjegjës			0		0
					0	0	0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2022			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce				

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësueseve përgjegjëse për të kryer trainimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Bordit të Kopshtit dhe për të themeluar Bordin e Kopshtit, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë.	Brenda vitit 2021-2023 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 30 për punësimin e drejtorëve për kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh

### 2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Sipas Urdhrit Nr.31.datë 28.01.2020, çdo institucion duhet të ngrejë Komisionin e tij.

Të gjithë kopshtet e qytetit të Korçës të intervistuar (10), e kanë ngritur komisionin.

Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga këshilli i prindërve.

Referuar të dhënave të mbledhura, 1 kopsht ka raportuar se në Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit nuk ka asnjë anëtar nga Këshilli i Prindërve; 3 kopshte janë shprehur se kanë nga një anëtar pjesë të Këshillit të Prindërve, 5 kopshte kanë raportuar se kanë dy anëtarë nga Këshilli i Prindërve dhe vetëm 1 kopsht ka 6 anëtarë nga Këshilli i Prindërve.

Ndërkohë për sa i takon mbledhjeve të Komisionit për t'i dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopsht ai duhet të mblidhet për të diskutuar problemet. Sipas analizës së të dhënave Komisioni mesatarisht është mbledhur rreth 2 herë në vit dhe maksimumi që ky Komision është mbledhur është 4 herë në vit.

Në kopshtet në godinë më vete, Këshilli i Prindërve, Bordi i kopshtit & Komisioni i Shëndetit funksionojnë më vete. Ndërsa, në kopshtet e integruara brenda godinave të shkollave, Këshilli i Prindërve, Bordi i kopshtit & Komisioni i Shëndetit, funksionon si një i vetëm për shkollën dhe kopshtin. Problematik mbetet fakti që Këshilli i Prindërve, Bordi i kopshtit & Komisioni i Shëndetit nuk funksionojnë në praktikë. Përfshirja apo vendimarrja e prindërve është e ulët duke qenë se nuk janë të njohur me kompetencat dhe rolin e tyre në këto organe.

*Objektiva kryesore:*

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

*Nën-objektivat:*

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht dhe ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës
2	Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte

*Indikatorët e performancës*

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Fshat	Vlere	Shumatore				
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Periferi	Vlere	Shumatore				
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Qender	Vlere	Shumatore				
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare				
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare				
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare				
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare				
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare				
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare				
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare				
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Qender	Vlere	Shumatore				
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Periferi	Vlere	Shumatore				
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Fshat	Vlere	Shumatore				
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Shumatore				
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Periferi	Vlere	Shumatore				
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Fshat	Vlere	Shumatore				

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periudhe
015	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0
014	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0

Lista e projekteve

Nr. 014	<b>Projekti:</b> Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Shumë pak kopshte nuk e kanë ngritur akoma Komisionin siç është e përcaktuar në urdhrin Nr. 31. Datë 28.01.2020. Ndërkohë duhet të rikujtojmë që një pjesë e madhe e këtyre kopshte vendodhen brenda shkollave dhe zakonisht ky komision funksionon edhe për kopshtin. Është shumë e rëndësishme specifikimi i rregullores ne funksion të mbarëvajtjes së kopshtit. Gjithashtu edhe specifikimi i nenit, sipas të cilit në rastin e kopshteve, Komisioni duhet të raportojë edhe pranë Bashkisë. Në këtë mënyrë Bashkia mund të monitorojë nga afër problematikat që vijnë nga kopshti dhe komuniteti, me qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, përfunksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë") janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton</p>		

nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.

Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit ose funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht. Gjithashtu, për kopshtet brenda godinave të shkollave ku Komisioni është i integruar me Komisionin e Shkollës shkakton të njëjtën problematikë.

## ii Synimi i projektit

1. Themelimi i Komisionit në çdo kopsht;
2. Ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës;
3. Informimi i Bashkisë rreth problemeve dhe tematikave, të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për t'i dhënë zgjidhje.

## iii Niveli i ndërhyrjes

### A: Ligjore

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shëndetit, për kopshtet ku nuk ka drejtor, ku përgjegjësia e themelimit të Komisionit sipas Udhëzimit nr. 31 i kalon një mësuesi.
2. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku kompetencën për themelimin dhe monitorimin e Komisionit të Shëndetit e ka

### B: Menaxheriale

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Komisionit të Shëndetit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës plotëson në Platformën Digjitale/njofton Keshilltaren për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korce herë që Komisioni mbledhet dhe çështjet që diskuton.

## iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht

## b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotëi tij në çdo kopsht							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brend bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe</li> </ul>							
e) <b>Shpenzimet e llogaritura</b> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) <b>Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023				g) <b>Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korçe			

Nr. 015	<b>Projekti:</b> Fuqizimii Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
Komisioni i Shëndetit mesatarisht është mbledhur 2 herë në vit në kopshtet e qytetit të Korçës dhe maksimumi që Komisioni është mbledhur është 4 herë në vit, ndërsa minimumi që është mbledhur është vetëm një herë në vit. Në kopshtet e NJA që ndodhen në godinat e shkollave, Komisioni i Shëndetit është i përbashkët me atë të shkollës.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 „Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë“) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjedisëve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të		



institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.

Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht.

**ii Synimi i projektit**

1. Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte.

**iii Niveli i ndërhyrjes**

**A: Menaxheriale**

1. Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce organizon një trajnim për drejtuesit e kopshtit për të drejtat dhe detyrimet e Komisionit, mënyrën e adresimit të problemeve, etj.
2. Drejtuesit e Kopshteve/Mësuesit përgjegjës organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve.

**iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce
2. Trajnimi i anëtarëve të Komisionit nga drejtuesit e kopshteve.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe drejtuesve të kopshteve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF
- Universiteti "Fan S. Noli"

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		0	0	0	0
2	Trajnimi i anëtarëve të Komisionit	Drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës		0	0	0	0
				0	0	0	0

**f) Periudha e zbatimit:**  
2021-2023

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**  
Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të shkaktojë pamundësi të mësueseve përgjegjëse për të kryer trainimet në Bashki, për të trainuar anëtarët e Komisionit dhe për të themeluar atë, për shkak të volumit të madh të përgjegjësive që kanë.	Brenda vitit 2021-2023 do të shihet mundësia që të zbatohet Udhëzimi Nr. 30 për punësimin e drejtorëve për kopshtet deri në 5 grupe fëmijësh.

### 3. Proceset Kryesore- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

#### 3.1 Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë viktime të dhunës dhe abuzimit, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

#### 3.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar;
3. Ngritja e një sistemi të unifikuar në nivel vendor për Bashkinë Korçë për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale;
4. Hartimi i politikave dhe ofrimit të paketës së shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopësht përlehtësimin e aksesit të tyre në kopësht;
5. Ofrimi i asistencës për fëmijët e identifikuar brendaambjentit të kopshtit. Ofrimi i shërbimit i paketës së shërbimeve psiko-sociale dhe shërbime të tjera në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese për të shmangur përjashtimin social.

### 3.3 Përfshirja sociale

#### 3.3.1 Koncepti i përfshirjes sociale

Koncepti i përfshirjes sociale zbulon natyrën e ndërthurur dhe shumë-përmasore të mungesës kronike që rrjedh nga përjashtimi social, si për shembull nga diskriminimi, që shërben si shtysë e rëndësishme e aspekteve më të thjeshta dhe lehtësisht të vëzhgueshme të varfërisë (mungesa e shkollimit, shëndeti i dobët, dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes apo kthimit në tregun e punës). Qasja në shërbime është thelbësore për përmirësimin e kushteve në bazë të cilave individët marrin pjesë në shoqëri, dhe mundësia për të kërkuar hapësirë për pjesëmarrje është thelbësore për

përfshirjen. Në këtë dokument ky koncept i referohet rasteve të fëmijëve në moshë për kopësht duke përfshirë kategoritë e fëmijëve të përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijë në moshë për kopësht por që nuk kanë akses për shumë arsye të ndryshme (mungesa e transportit, vështirësi për të marrë informacion, mosplotësim informacioni).

### 3.3.2 Identifikimi i nevojave për përfshirje sociale

#### *Informacion i përgjithshëm*

Ne Bashkinë Korçë është ngritur Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NVNR). NVNR ka rol në identifikimin e nevojave për shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë duke përfshirë grupin e fëmijëve në sistemin arsimit parashkollor që përballen me përjashtimin social si rrjedhojë e varfërisë, mungesës së punësimit, shëndetit, diskriminimit, strehimit të sigurt, etj. Kjo njësi prodhon të dhëna të numrit të fëmijëve gjithsej që janë të identifikuar në nevojë. Ende nuk ka informacion specifik për fëmijet në moshë kopështi të të gjitha profileve dhe nevojave.

Bashkia ka në strukturën e saj organizative një grup proaktiv për identifikimin e fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale. Ajo i identifikon fëmijët me nevojë për përfshirje sociale nëpërmjet raportimit të stafit të shkollave dhe kopshteve, familjeve që marrin ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara.

Numri i fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Korçë është 241 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian.

#### *Objektiva kryesore:*

Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj);

#### *Nën-objektivat:*

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Shtirja e funksionit të NVNR-se pranë çdo njësie administrative me 10 mijë banorë
2	Identifikimi dhe vlerësimi i fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social

*Indikatorët e performancës*

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
031	Numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti	Qender	Vlere	Shumatore				
031	Numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti	Periferi	Vlere	Shumatore				
031	Numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti	Fshat	Vlere	Shumatore				
032	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti të regjistruar në kopsht (%)	Qender	%	Tjeter				
032	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti të regjistruar në kopsht (%)	Periferi	%	Tjeter				
032	Fëmijë në nevojë për përfshirje	Fshat	%	Tjeter				



Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	sociale në moshë kopshti të regjistruar në kopsht (%)							
033	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti të identifikuar nga grupet e terrenit (%)	Qender	%	Tjeter				
033	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti të identifikuar nga grupet e terrenit (%)	Periferi	%	Tjeter				
033	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti të identifikuar nga grupet e terrenit (%)	Fshat	%	Tjeter				

### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periodhe
017	Ngritja e një sistemi bashkëpunimi dhe komunikimi për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirje sociale, në situatë rruge, etj.	Drejtoria e Kujdesit Social		2460	2460	2460	7380
016	Ngritja e skuadrave të terrenit për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale në komunitet dhe fëmijëve në situatë rruge	Drejtoria e Kujdesit Social		3168	3168	3168	9504

### Listat projekteve

Nr. 016	<b>Projekti:</b> Ngritja e skuadrave të terrenit për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në nevojë përfshirjes sociale në komunitet dhe fëmijëve në situatë rruge	<b>Programi Buxhetor:</b> 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët  <b>Funksioni:</b> 10
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Në Bashkinë e Korçës aktualisht janë të punësuar 13 administratorë shoqërorë dhe 1 punonjës për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Korçë. Shpërndarja e punonjësve socialë nuk është e qartë, ndërsa administratorët shoqërorë (që luajnë dhe rolin e PMF), janë të ndarë:</p>		



- 6 administratorë për rajonet e qytetit të Korçës
- 7 administratorë për NJA.

Bashkia është shprehur se gjithashtu, nuk ka grupe terreni aktive për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge dhe në nevojë për përfshirje sociale.

#### Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Sipas Ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, bashkia duhet të ketë struktura të ngritura në dy nivele:

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki;
2. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, e krijuar në nivelin e njësive administrative.

Aktualisht, Bashkia Korçë ka në strukturën e saj 6 specialistë që kanë formuar 2 grupe terreni për identifikimin e fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale. Gjithashtu, fëmijët identifikohen nëpërmjet raportimit të stafit të shkollave dhe kopshteve, familjeve që marrin ndihmë ekonomike dhe familjet që kanë anëtarë me aftësi të kufizuar.

#### ii Synimi i projektit

Skuadrat e terrenit kanë në fokus identifikimin proaktiv të fëmijëve në moshë për kopsht të cilët nuk e frekuentojnë kopshtin ose nuk e ndjekin rregullisht atë. Synimi është që nëpërmjet punës në terren të trajtohet dhe raportohet çdo rast i fëmijëve që për shkak të faktorëve të jashtëm nuk arrijnë të kenë akses në kopsht apo të mos e frekuentojnë rregullisht atë. Këto faktorë mund të jenë ekonomik dhe social. Skuadrat e terrenit identifikojnë në mënyrë periodike.

Në rast se gjatë identifikimit raportohet se ka fëmijë në rrezik të lartë atëherë ndodh referim rasti brenda 24 orëve dhe në kushtet e nivelit të rrezikut të lartë ka si referencë VKM 578, i cili rregullon procedurat e menaxhimit të rastit. Nëpërmjet këtyre procedurave, fëmijët e identifikuar në nevojë përmbështetje dhe trajtim, raportohen edhe si fëmijë, të cilët duhet të referohen pranë shërbimeve konkrete për përfshirje sociale.

#### iii Niveli i ndërhyrjes

##### A: Ligjore

1. Miratimi i buxhetit për shpenzimet e Grupeve të Terrenit gjatë punës së tyre nga KB.

##### B: Menaxheriale

1. Bashkia, nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Kujdesit Social, ngre grupet e skuadrave të terrenit. Skuadrat e terrenit përbëhen nga 6 specialistë. Momentalisht ekzistojnë 2 grupe me nga 3 anëtarë.
2. Drejtoria e Kujdesit Social harton dhe miraton planin e punës së ekipeve, të cilat identifikojnë në mënyrë proaktive në terren fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, ku përfshihen edhe fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu, vlerëson shpenzimet operative mujore për çdo grup terreni (kostot e transportit, dieta, etj.)
3. Pjesë të skuadrave të terrenit mund të jenë edhe punonjësit social pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, punonjës të qendrave komunitare dhe punonjës të organizatave me të njëjtin fokus, vullnetarë nga komuniteti, etj.
4. Identifikimi në mënyrë proaktive në terren i fëmijëve që nuk kanë akses në kopsht duke përfshirë edhe fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, ku ërfshihen edhe fëmijët në situatë rruge apo fëmijë në rrezik për mbrojtje;
5. Raportimi i rasteve te Drejtoria e Kujdesit Social për të ofruar trajtimin e tyre;
6. Plotësimi i Platformës Digjitale për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe situatë rruge për të krijuar një databazë të saktën ga Drejtoria e Kujdesit Social.

#### **iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Miratimi në KB i buxhetit për shpenzimet operative të grupeve të terrenit;
2. Ngritja e grupeve të terrenit nga Drejtoria e Kujdesit Social, hartimi I planit të punës dhe ndarja e ekipeve;
3. Kryerja e vizitave periodike në terren nga Skuadrat e Terrenit.

#### **b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)**

1. Identifikimi I të gjithë femijeve në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti, fëmijëve në situatë rruge dhe ne nevoje per mbrojtje;
2. Krijimi I databazës me të dhëna të këtyre fëmijëve dhe ecurinë e rastit të tyre.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)

- Drejtoria e Kujdesit Social;

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF;
- Qendrat komunitare;
- Universiteti “Fan Noli”.

#### **e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)**

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Miratimi në KB I shpenzimeve operative të grupeve të terrenit	Drejtoria e Kujdesit Social					0
2	Ngritja e Grupeve të Terrenit	Drejtoria e Kujdesit Social		3168	3168	3168	9504
3	Kryerja e vizitave në terren	Drejtoria e Kujdesit Social		0	0	0	0
				3168	3168	3168	9504
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Kujdesit Social				

<b>Nr. 017</b>	<b>Projekti:</b> Ngritja e një sistemi bashkëpunimi dhe komunikimi për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirje sociale, në situatë rruge, etj.	<b>ProgramiBuxhetor:</b> 10430 - Kujdesi social përfamiljet dhe fëmijët  <b>Funksioni:</b> 10
<b>a)Përshkrim I shkurtër I projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
<p>Bashkia Korçë nuk e ka zgjeruar funksionin e Njesisë se Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) pranë Njësive Administrative. NJVNR ka rol në identifikimin e nevojave për shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë duke përfshirë grupin e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor që përballen me përjashtimin social si rrjedhojë e varfërisë, shëndetit, diskriminimit, strehimit të sigurt, etj. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të numrit të fëmijëve gjithsej që janë të identifikuar në nevojë në moshë për kopsht të të gjitha profileve të nevojave.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Si rrjedhojë e mungesës së NJVNR në Njësitë Administrative janë hasur këto probleme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ka mungesë të informacionit për fëmijët në kushtet e përjashtimit social dhe me potencial për të përfituar shërbimet e kopshtit;</li> </ul>		

- ka mungesë të vlerësimit të nevojave të grupeve në nevojë për hartimin e politikave, ngritjes së shërbimeve dhe adresimit të nevojave në nivel Bashkie;
- ka mospërputhje të theksuar informacioni ndërmjet ZVAP, Bashkisë, Njësive Administrative dhe kopshteve mbi numrin e fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale;
- ka mungesë të paketave të lehtësimit për përfshirjen sociale si frekuentimi I kopshtit pa pagesë për fëmijët rom dhe egjiptian dhe për fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:

a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë (Nenet 36 dhe 37 të Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”);

b) administrator shoqëror (Detyra sipas ligjit për ndihmën ekonomike)

Mungesa e punonjësve socialë në nivelin e njësive administrative ka bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve ligjore në këtë nivel, për rrjedhojë, zakonisht strukturat përgjegjëse të shërbimeve sociale në bashki angazhohen drejtpërdrejt edhe në menaxhimin e rasteve të ndryshme sociale. Kjo sjell jo vetëm ezaurim të panevojshëm të stafeve që në fakt nuk kanë detyrë funksionale menaxhimin e rasteve, por nuk është as në përputhje me interesin e vetë individëve në nevojë, të cilët duhet të përshkojnë distance nga vendbanimi i tyre deri në bashki, duke shmangur kështu njësinë administrative.

## ii Synimi i projektit

Synimi I këtij projekti është ngritja e një sistemi bashkëpunimi dhe komunikimi për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirje sociale, në situatë rruge, etj., duke qenë se të gjitha NJA kanë më pak se 10,000 banorë. Nëpërmjet ngritjes së kësaj strukture synohet të:

1. Identifikohen dhe vlerësohen fëmijët pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, etj);
2. Ngrihet një system I unifikuar për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti;
3. Hartohen politika dhe ofrohet paketa e shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopsht;
4. Ofrohet asistencë për fëmijët e identifikuar me nevoja të ndryshme Brenda ambjentit të kopshtit.

## iii Niveli I ndërhyrjes

### A: Ligjore

Sipas Ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, është detyra e Bashkisë të zgjeroje pranë Njësive Administrative me gjashtë deri në dhjetë mijë banorë shërbimin e Njësive se Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe t'u shtojë atyre si detyre funksionale këto shërbim brenda organikes ekzistuese. Për këtë arsye është i nevojshëm:

1. Urdhër nga Kryetari I Bashkisë për ngritjen e sistemit të bashkëpunimit dhe referimit.

### **B: Menaxheriale**

NJVNR, duhet të ketë të paktën:

1. Një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6,000 derinë 10,000 banorë;
2. administrator shoqëror.

Bashkia ka në strukturën e saj 13 administratorë shoqërorë, 6 në qytet dhe 7 në NJA. Administratorët e NJA do të bëjnë pjesë në strukturën e NJVNR. Bashkia Korçë ka 6 punonjës social, dhe për të ngritur këtë structure është e nevojshme që 3 punonjës të kalojnë në këtë strukturë. Detyrat e strukturës do të jenë:

1. Identifikimi I rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë
2. Vlerësimi fillestar I nevojave dhe riskun për individët në nevojë
3. Informimi dhe këshillimi public mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla
4. Hartimi I planit individual të përkujesit dhe mbështetjes
5. Bashkërendimi I mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimi te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm
6. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që për mbush nevojat e individit
7. Mbikëqyrja në vazhdimësi e ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimi për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar
8. Hedhja në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016
9. Aplikimi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
10. Plotësimi në Platformën Digjitale të dhënave për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë.

### **iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Drejtoria e Kujdesit Social në bashkëpunim me Këshilltaren për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse rristrukturojnë burimet njerëzore (punonjësit social, administratorët shoqërorë, PMF, etj.) për të krijuar organogramën e kësaj strukture;

<p>2. Paraqitja e structures në Këshillin Bashkiak për miratimin e ndryshimeve strukturore dhe buxhetit të pagave të punonjësve të rinj. Lobimi në Këshillin Bashkiak për miratimin në buxhet të pagave të punonjësve; Një page në kategorinë II.a = 79 mijë lekë dhe një page në kategorinë III.a = 63 mijë lekë. Në këtë strukturë do të jenë 2 punonjës të kategorisë III.a dhe një punonjës në kategorinë II.a.</p> <p>3. Pas miratimit nga KB, fillon ngritja e strukturës;</p> <p>4. Drejtoria e Kujdesit Social është përgjegjëse për ngritjen e këtyre strukturave.</p>							
<p><b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b></p> <p>1. Ngritja e structures për bashkëpunim dhe referim të rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për kujdes social;</p> <p>2. Identifikimi I fëmijëve në moshë kopshti me nevojë për përfshirje sociale;</p> <p>3. Trajtimi në mënyrë efikase I çdo rasti të identifikuar.</p>							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Kujdesit Social</li> <li>Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce</li> </ul>				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <p>- Organizata ndërkombëtare (Save the children)</p>			
<p><b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b></p>							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Krijimi I organogramës	Drejtoria e Kujdesit Social					0
2	Paraqitja në KB	Drejtoria e Kujdesit Social					0
3	Ngritja e strukturës – rekrutimi I stafit	Drejtoria e Kujdesit Social		2460	2460	2460	7380
				2460	2460	2460	7380
<p><b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023</p>				<p><b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Kujdesit Social</p>			

*Risqet*

<b>Risku</b>	<b>Mitigimi</b>
Bashkia Korçë per shkak te emergjencaveqe mund te ndodhin mund te mos prioritizojë shperndarjen e funksionit te NJVNR-se.	Do të llohet për rëndësinë e zgjerimit te funksionimit të strukturës

### 3.3.3 Ndhimja e përditshme

#### Informacion i përgjithshëm

Gjatë vitit shkollor 2019-2020 në kopshtet e Bashkisë Korçë janë regjistruar 1706 fëmijë, prej të cilëve 780 janë vajza. Bashkia Korçë ka kapacitetet akomodues për **2245** fëmijë në kopshtet publike, për të tre grupet e fëmijëve (grupi I parë, grupi I dytë dhe grupi I tretë). Numri I fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale është: 241 fëmijë të komunitet rom dhe egjiptian, asnjë fëmijë në nevojë për mbrojtje në moshë për kopësht dhe 8 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Bashkia Korçë nuk ka paketa lehtësuese apo mbështetëse për fëmijët të cilët janë në nevojë për mbrojtje apo për fëmijë që nuk frekuentojnë kopshtet për shkak të përjashtimit social.

#### Objektiva kryesore:

Përmirësimi I trajtimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijë të egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë viktime të dhunës në familje apo abuzimi, etj);

#### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Hartimi dhe ofrimi I paketës së shërbimeve lehtësuese për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti në mënyrë që të nxitet regjistrimi/frekuentimi I tyre në kopsht.

#### Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
034	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale që përfitojnë nga paketat lehtësuese (%)	Qender	%	Tjeter				
034	Fëmijë në nevojë për	Periferi	%	Tjeter				





Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2021	Plan Vit 2022	Plan Vit 2023
	përfshirje sociale që përfitojnë nga paketat lehtësuese (%)							
034	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale që përfitojnë nga paketat lehtësuese (%)	Fshat	%	Tjeter				
035	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale që kanë përftuar shërbimin e psikologut (%)	Qender	%	Tjeter				
035	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale që kanë përftuar shërbimin e psikologut (%)	Periferi	%	Tjeter				
035	Fëmijë në nevojë për përfshirje sociale që kanë përftuar shërbimin e psikologut (%)	Fshat	%	Tjeter				

*Lista e Aksioneve*

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periodhe
018	Ofrimi I paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë	Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë, NSHMAC		24.75	24.75	24.75	74.25

*Listat e projekteve*

<b>Nr. 018</b>	<b>Projekti:</b> Ofrimi I paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor  <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>I Situata</b>		
Bashkia Korçë nuk ka të planifikuar asnjë paketë lehtësuese për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Gjatë vitit shkollor 2019-2020 në kopshtet e Bashkisë Korçë janë regjistruar 241 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian dhe 8 fëmijë me aftësi të kufizuara. Ndër të cilët asnjë nuk e ka përfituar kopshtin pa pagesë.		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
Për të rritur frekuentimin në kopshte të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (rom, egjiptian, fëmijë që vijnë nga familje të asistuar me ndihmë ekonomike), me aftësi të kufizuara dhe në nevojë për mbrojtje është e nevojshme që të ofrohen paketa lehtësuese për prindërit e fëmijëve. Një prej këtyre paketave është regjistrimi i fëmijëve në kopshte me drekë pa pagesë.		
Kjo nismë jo vetëm që rrit normën e frekuentimit të fëmijëve që janë tashmë të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Korçë, por gjithashtu nxit prindërit, që nuk i kanë regjistruar më		

parë fëmijët në kopsht për t’I regjistruar. Në këtë mënyrë, rritet norma e regjistrimit të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje ose me aftësi të kufizuara në kopsht.

### iii Niveli I ndërhyrjes

#### A: Ligjore

1. Miratimi në KB I paketës lehtësuese për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

#### B: Menaxheriale

1. Hartimi I paketës lehtësuese nga Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë në bashkëpunim me Qendrën Ekonomike. Në paketë përfshihet numri I fëmijëve që do të përfitojnë nga ky shërbim, kopshtet në të cilat do të regjistrohen dhe kostot mujore për fëmijë;
2. Identifikimi I fëmijëve në nevojë për përfshirjesociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara nëpërmjet Platformës Digjitale;
3. Regjistrimi I fëmijëve në kopshtet me drekë pa pagesë.

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi I paketës lehtësuese;
2. Miratimi I paketës lehtësuese në KB;
3. Zbatimi I paketës lehtësuese.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritja e frekuentimit në kopsht të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara;
2. Rritja e regjistrimit të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)

- Keshilltarja për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Korçë;
- NSHMAC

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Bashkia Korçë
- Donator
- OJF

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Hartimi I paketës lehtësuese	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce					0
2	Miratimi I paketës Lehtësuese në KB	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce					0
3	Zbatimi I paketës lehtësuese	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce		24.75	24.75	24.75	74.25
				24.75	24.75	24.75	74.25
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021-2023			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce				

### Risqet

Risku	Mitigimi
Rotacionet politike mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e miratimit të paketave lehtësuese dhe të zbatimit të saj.	Do të llobohet për rëndësinë që kanë këto paketa në rritjen e frekuentimit të kopshtit të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale.

### 3.4 Mbrojtja e fëmijëve

#### 3.4.1 Identifikimi I abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës

##### *Informacion i përgjithshëm*

Në Bashkinë Korçë, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, është një strukturë e atashuar pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, në përbërje të të cilës janë dy punonjës për mbrojtjen e fëmijëve. Pranë Njësive Administrative nuk ka PMF të dedikuar, por ky rol kryhet nga Administratori social. Në Bashkinë Korçë në total janë të punësuar 7 Administratorë Social, 1 Administrator për Njësi. Në Qytetin e Korçës janë të punësuar 6 Administratorë Social, 1 Administrator për Rajon.

Nuk ka patur raste të identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në kopshtet e Bashkisë Korçë. Çdo rast I identifikuar në nevojë për mbrojtje duhet të raportohet pranë NJMF. Kopshtet nuk kanë një person të caktuar si person përgjegjës për të asistuar punonjësit për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve. Në Qytetin e Korçës nuk ka asnjë fëmijë në moshë për kopsht.

##### *Objektiva kryesore:*

Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi I rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

##### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpërmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre
2	Organizimi I paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t'u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë proces
3	Vendosja e PMF në kontakt me stafin e kopshteve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve
4	Çdo kopsht ka të hartuar, të miratuar dhe të njohur nga stafet, politikat e mbrojtjes së fëmijëve

*Indikatorët e performancës*

<b>Kod i</b>	<b>Indikatori</b>	<b>Shpërndarja gjeografike</b>	<b>Matje ne:</b>	<b>Agregimi</b>	<b>Fakt Aktua l</b>	<b>Plan Vit 202 1</b>	<b>Plan Vit 202 2</b>	<b>Plan Vit 202 3</b>
036	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar nga PMF	Periferi	Vlere	Mesatare				
036	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar nga PMF	Fshat	Vlere	Mesatare				
036	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar nga PMF	Qender	Vlere	Mesatare				
037	Numri I fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë kopshti	Fshat	Vlere	Shumator e				
037	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë kopshti	Periferi	Vlere	Shumator e				
037	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë kopshti	Qender	Vlere	Shumator e				
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të regjistruar në kopsht (%)	Fshat	%	Tjeter				
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të regjistruar në kopsht (%)	Periferi	%	Tjeter				
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të regjistruar në kopsht (%)	Qender	%	Tjeter				



039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi I kopshtit (%)	Fshat	%	Tjeter				
039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi I kopshtit (%)	Periferi	%	Tjeter				
039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi I kopshtit (%)	Qender	%	Tjeter				
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e mbrojtjessëfëmijëve (%)	Fshat	%	Tjeter				
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e mbrojtjes së fëmijëve (%)	Periferi	%	Tjeter				
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e mbrojtjes së fëmijëve (%)	Qender	%	Tjeter				
042	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Fshat	Vlere	Mesatare				
042	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Periferi	Vlere	Mesatare				
042	Numri I stafit të kopshtit I trajnuar mbi politikat e	Qender	Vlere	Mesatare				

mbrojtjes së fëmijëve							
-----------------------	--	--	--	--	--	--	--

*Lista e Aksioneve*

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2021	Buxhet Vit 2022	Buxhet Vit 2023	Total periodhe
021	Shtimi I psikologëve në Njësinë e Arsimit Parashkollor	Drejtoria Shërbimit Social			2736	2736	5472
020	Vendosja dhe promovimi I një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor I cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion	Keshilltarja per Arsimin Parashkollor ne Bashkinë Korce					0
019	Hartimi I një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme përfëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike ne kopshte	Drejtoria e Kujdesit Social					0



Listae projekteve

<p>Nr. 019</p>	<p><b>Projekti:</b> Hartimi I një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike ne kopshte</p>	<p><b>Programi Buxhetor:</b>10430 - Kujdesi social përfamiljet dhe fëmijët</p> <p><b>Funksioni:</b> 10</p>
<p><b>a)Përshkrim I shkurtër I projektit</b></p>		
<p><b>I Situata</b></p> <p>Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.</p> <p>Ligji shpreh qartësisht mbrojtjen e interes më të lartë të fëmijës në të gjitha format dhe mënyrat dhe dokumenti I politikave të mbrojtjes së fëmijëve garanton që në të gjitha sistemet dhe atë të sistemit të arsimit parashkollor të jetë I familjarizuar më të gjitha praktikat dhe procedurat për parandalimin e formave të abuzimit, identifikimin e fëmijëve nënevojë për mbrojtje, raportimin dhe trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</p>		
<p><b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b></p>		
<p>Zinxhiri i komunikimit mes kopshtit dhe Bashkisë nuk është I qartë në kopshtet që menaxhohen nga drejtorët e shkollave të arsimit bazë. Gjithashtu, një pjesë e këtyre kopshteve kanë vetëm 1 mësuese të punësuar, e cila menaxhon vetëm një grup të përzier me mosha të ndryshme fëmijësh, çka vështirëson akoma më shumë komunikimin kopsht-bashki. Përsa I përket referimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, deri tani nuk ka pasur asnjë referim të ardhur nga kopshtet (mësueset, drejtuesi, etj).</p> <p>NJMF pranë Drejtorisë së Kujdesit Social dhe PMF duhet të sigurohen që ligji 18/2017 është I qartë dhe I kuptueshëm për të gjithë stafin e kopshteve dhe bashkisë që janë në kontakt me fëmijët. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohet një document bazuar në këtë ligj mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve, të përshtatur në gjuhë të kuptueshme jo vetëm për stafin e kopshteve, por edhe për vetë fëmijët, prindërit dhe partnerë të tjerë.</p>		
<p><b>ii Synimi I projektit</b></p>		
<p>Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jetë një document udhëheqës për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet educative parashkollore nën administrimin e bashkive në të cilat punohet me / për fëmijë, për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqënien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit.</p>		

Ky document synon të nxisë garantimin e një sjelljeje institucionale, më të përgjegjshme në kopshtet dhe jo vetëm në bashki në funksion të krijimit të ambjenteve më të sigurta për të gjithë fëmijët.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka udhëzime dhe procedura të qarta të cilat do t'i ndihmojnë stafet kopshteve në identifikimin e rasteve të abuzimit në mjediset e institucionit si dhe raportimin apo referimin e çdo rasti të abuzimit të fëmijëve. Këto procedura duhet të jenë të qarta edhe për bordet drejtuese dhe këshillin e prindërve.

Rëndësia e kësaj politike shtrihet në qartësimin e roleve, përgjegjësi, procedurave dhe rregullave për shqetësime që dalin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ajo do të ndihmojë kopshtet të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

### **iii Niveli I ndërhyrjes**

#### **A: Ligjore**

1. Miratimi I dokumentit mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës në Këshillin Bashkiak;
2. Ky document bëhet pjesë e kontratës së çdo mësuesi, ku këta të fundit nënshkruajnë për kuptueshmërinë e tij dhe mbajnë përgjegjësi për të.

#### **B: Menaxheriale**

1. Drejtoria e Kujdesit Social, NJMF dhe PMF dhe në bashkëpunim me ZVAP dhe/ose OJF të profilizuara në fushën e arsimit ngre grupin e punës për përgatitjen e dokumentit, duke u përkujdesur që të përfshijë dhe specifika që lidhen me kulturën dhe kontekstin e secilës zonë;
2. Kryhen konsultime me mësues dhe prindër për të finalizuar më pas dokumentin.
3. Dokumenti kalon për miratim në KB;
4. Pjesë e dokumentit është kodi I sjelljes së çdo punonjësi që është në kontakt me fëmijën, si praktikantë, vullnetarë, mësues, etj;
5. Vendoset personi I kontaktit në çdo kopsht për mbrojtjen e fëmijëve duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e tij (Projektfisha nr 014);
6. Hartohen procedurat për raportimin e shqetësimeve dhe incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Hartimi I një aneksi Brenda dokumentit për sjelljen dhe trajtimin që duhet të ketë media në çështje që lidhen me fëmijët.

### **iv Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e dokumentit;
2. Konsultimi me prindër dhe mësues;
3. Miratiminë KB;
4. Promovimi I dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme;

5. Informim I stafit të kopshtit për politikat e mbrojtjes së fëmijëve							
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>							
<ol style="list-style-type: none"> <li>Hartimi I dokumentit mbi Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve;</li> <li>Njohja më e mirë e stafit të kopshteve, prindërve dhe fëmijëve me Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve;</li> <li>Pajisja e çdo kopshti me një praktikë të miratuar ligjore të përshtatur sipas grupmohës së fëmijëve në kopsht që siguron mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.</li> </ol>							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira Brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Total
1	Ngritja e Grupit të Punës	Drejtorja e Kujdesit Social		0			0
2	Konsultimi me prindër dhe mësues	Drejtorja e Kujdesit Social		0			0
3	Miratimi në KB	Drejtorja e Kujdesit Social		0			0
4	Promovimi I dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme	Drejtorja e Kujdesit Social		0			0
5	Informim I stafit të kopshtit për politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Drejtorja e Kujdesit Social		0			0
				0			0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2021				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtorja e Kujdesit Social			

<p>Nr. 020</p>	<p><b>Projekti:</b> Vendosja dhe promovimi I një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor I cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion</p>	<p><b>Programi Buxhetor:</b> 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</p> <p><b>Funksioni:</b> 09</p>
<p><b>a)Përshkrim I shkurtër I projektit</b></p>		
